



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KAMEZ




PROJEKT ZBATIMI

RRUGA THEMISTOKLI GERMENJI, RRUGA " SHTESA VANGJEL KOCA".

BABRRU-SHPAT,FUSHE-KËRÇIK.

Punoi:
Ing. Eva Lalaj
Ing. Hajredin Murgu
Ing. Xhevahir Zeneli



Drejtori i P.K.ZH.T-se
Ark. Arber TOLA

MIRATOI

Xhelal MZIU

K R Y E T A R

OBJEKTI: *Projekt Zbatimi Ndertim Rruga "THEMISTOKLI GERMENJI" RRUGA*
"SHTESA VANGJEL KOCA", BABRRU SHPAT,FUSHË - KËRÇIK.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TË PËRGJITHSHME

- 1.1- Hyrje
- 1.2- Pozicioni i objektit
- 1.3- Gjendja Ekzistuese
- 1.4- Kushtet Klimatike te Zones
- 1.5- Rilevimi Topografik
- 1.6- Studimi Gjeologjik

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1- Projektet te Rrugeve jane ndare ne disa pjese

a- Projekti i KUB te Rugeve

Projekti i Rrugeve Projekt Zbatimi Ndertim Rruga "THEMISTOKLI GERMENJI"

RRUGA "SHTESA VANGJEL KOCA", BABRRU SHPAT,FUSHË - KËRÇIK.

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

OBJEKTI: Projekt Zbatimi Ndertim Rruga "THEMISTOKLI GERMENJI" RRUGA

"SHTESA VANGJEL KOCA", BABRRU SHPAT,FUSHË - KËRÇIK.

Bashkia Kamez

1. PERMBAJTJA E PROJEKT-ZBATIMIT

1) TE PERGJITHSHME

1.1-Hyrje

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion do te realizoje projektin e zbatimit per objektin :

Projekt Zbatimi Ndertim Rruga THEMISTOKLI GERMENJI" RRUGA "SHTESA VANGJEL KOCA", BABRRU SHPAT,FUSHË - KËRÇIK.

1.2-Pozicioni gjeografik i objektit

Zona që merret në studim gjëndet në Paskuqan (Babrru Shpat,Fushe-Kërçik)

- Kamza është një qytet që shtrihet ne kufijtë veriorë të qytetit të Tiranës, që është rritur me ritme të jashtëzakonshme në dhjetëvjeçarin e fundit dhe pritet të vazhdojë rritjen demografike me ritme të konsiderueshme në 20 vitet e ardhshme.
- Zona qe trajtohet ne kete projekt perfaqeson nje teren me pjerrresi te bute ne drejtim te lindjes e cila ndodhet prane lumit te Tiranes. Kjo perfaqeson nje zone urbane relativisht te dendur veçanerisht, me ndertime 1-5 kate .

1.3 -Gjendja ekzistuese

Gjendja aktuale e objektit paraqitet:

Projekt Zbatimi Ndertim Rruga " THEMISTOKLI GERMENJI" RRUGA "SHTESA VANGJEL KOCA", BABRRU SHPAT,FUSHË - KËRÇIK.

Ështe një rrugë qe duhet te behet me standarte .

Rruga ka trotuare vetëm në njërin krah te saj.

- Kjo Zone ka Trotuare.

1.4 - Kushtet Klimatike te Zones

Zona dallohet per dimer te bute me karakteristika te theksuara mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit eshte e ndjeshme .

Si gjithë zona mesdhetare, ne pergjithesi ka nje sasi te konsiderueshme kohe me diell. Kjo arrin ne 2560 ore ne vit, me maksimum ne muajin Korrik me 360 ore dhe minimum 100 ore ne Dhjetor .

Presioni atmosferik sipas te dhenave shume vjeçare leviz nga 752-753 milimetra, e barabarte kjo me 1002.6-100.9 milibar.

Vlerat e temperatures se ajrit ne pergjithesi jane te qendrueshme .

Periudha me temperatura mesatare $> 7^{\circ}\text{C}$ zgjat afersisht 10 muaj.

Kjo zone perfshihet ne zonen klimaterike mesdhetare fushore qendrore. Temperatura mesatare vjetore leviz ne $15-16^{\circ}\text{C}$. Temperatura maksimale eshte regjistruar ne date 13.07.1973 me 43°C , ndersa temperatura minimale eshte regjistruar ne date 15.01.1968 me -14.4°C .

Reshjet, kryesisht në formën e shiut, janë përgjithësisht të dendura gjatë vitit . Periudha e ngricave është kryesisht në muajt dhjetor-shkurt . Periudha e ngricave është kryesisht në muajt dhjetor-shkurt .

Erërat që fryjnë nuk i kalojnë shpejtësitë 30-50 km/ore . Ujrat nentokesore jane ne kete zone me nivel statik nen thellesine 2 m ne kete aspekt ujrat nentokesore nuk kane ndonje ndikim direkt ne parametrat gjeoteknik te bazes se rrugeve deri ne thellesine 1m. Keto vleresime jane thelbesore per çdo projekt ndertimor dhe hidroteknik

Gjurma e rrugeve

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion ka realizuar projektin e zbatimit per objektin :

OBJEKTI: Projekt Zbatimi Ndertim Rruga THEMISTOKLI GERMENJI" RRUGA

"SHTESA VANGJEL KOCA", BABRRU SHPAT,FUSHË - KËRÇIK.

2.1 PERSHKRIMI I RRUGEVE

1. DETYRA E PROJEKTIT

Per komponentin “ NDERTIMI I RRUGEVE “

- Shtresat e rruges te trajtohen te tilla qe te sigurojne garanci per rrugen, qendrueshmeri dhe te perballojne kapacitetet faktike dhe te perspektives (te pakten per nje periudhe 25 vjeçare). Gjate hartimit te projektit te shikohet mundesia e ndertimit te parkingjeve, si dhe vendet e konteniereve.
- Do te hartohet projekti dhe preventivi per fazen e zbatimit, shoqeruar me specifikimet teknike perkatese, per rehabilitimin e rrjetit rrugor dhe ndertimin e rrugeve te reja, ne perputhje me planin urbanistik te pergatitur nga Bashkia dhe ne konformitet me kerkesat e veçanta per rruget te pershkruara ne kete detyre projektimi.

2.1- KERKESAT E VEÇANTA TE PROJEKTIT

- Me qellim qe te parashikohet qe ne fazen e projektimit cilesi e larte e zbatimit te punimeve rehabilituese, gjate hartimit te projektit, specifikimeve teknike dhe preventivit te vepres duhet te kihen parasysh kerkesat e veçanta te renditura ketu me poshte:

HIDROLOGJIA

- Rajoni i Kamzes perfshin troje ne zonen fushore me relieuv subhorizontal
- Tiparet e relievit , kane tipare hidrogjeologjike dhe gjeologjike te veçanta ,me shkalle te ulet konsolidimi.
- Ujrat nentoksore jane ne kete zone me nivel statik nen thellesine 2m÷3m; ne kete aspekt ujrat nentoksore deri diku kane ndonje ndikim direkt ne parametrat gjeoteknik te bazes se rrugeve prandaj ne pjesen me kuote me te ulet parashikohet qe te kete nje shtrese me **mbushje me çakull** ~10cm vende vende tek segmenti i **II**
- Keto vleresime jane thelbesore per çdo projekt ndertimor dhe hidroteknik.

KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE DHE HIDROGJEOLOGJIKE MBI KUSHTET GJEOLIGO -INXHINIERIKE TE ZONES se KAMZES

- Ne kuader te hartimit te projektit per rehabilitimin e infrastruktures te zones kryen punime gjeologo inxhinierike gjate gjithë gjatesise rruges se ketij projekti
- Krahas kesaj u studiuuan gjithashtu dhe u moren ne konsiderate te dhena te studimeve te meparshme per kete zone te cilat na japin nje kuader te plote te saj.

NDERTIMI GJEOLOGJIK I RAJONIT DHE KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE TE ZONES

- Nga ana e ndertimit gjeologjik, rajoni i Tiranes ben pjese ne strukturen e sinklinalit te Tiranes e cila ndertohet kryesisht nga formacione e moshes se Neogenit (N 2) - Keto formacione ndertojne vargjet kodrinore qe qarkojne qytetin dhe perfaqeson nga pako ranore , alevrolite dhe argjila alevrolitike . Gjithashtu keto formacione sherbejne si bazament i depozitimit me te reja kuaternare . Depozitimet kuaternare ndertojne gjith pjesen fushore ku eshte ndertuar qyteti i Kamzes ku bejne pjese zona ne studim. Keto depozitime perfaqesohen nga dhera suargjillore, suranore , si dhe depozitime aluvionale zhavorore te lumenjvete Tiranes dhe te Lanes dhe te teracave te tyre, trashesia e pergjitheshme e te cilave arrin 3-4 m ekstremet e fushes deri ne rreth 20m ne pjeset e tjera te qytetit.
- Era fryn pergjithesisht ne dy drejtime gjate gjysmes se ftohte te vitit mbizoteron juglindja paperjashtuar veriun , ne gjysmen e ngrohje te vitit mbizoteron veriperendimi.

Klauzola qe nuk aplikohen .

- Çfare do Klauzole e specifikimeve qe lidhet me punime apo materiale qe nuk kerkohen ne Preventiv (Tabela e Volumeve) do te konsiderohet e paaplikueshme .

Kushtet sizmike

- Megjithese te gjitha strukturat jane hartuar per kushte sizmike .Kontraktori do te njihet vete me kushtet sizmike te zones nga ku kalon rruga dhe do te marre parasysh ndikimin ne çmim per ti pershtatur punime me Kodin sizmik te vendit .

Kushtet atmosferike dhe permbytjet .

- Do te merret si e mireqene qe kontraktori gjate perгатitjes se ofertes se tij do te kete marre parasysh te gjitha kushtet e mundeshme atmosferike dhe rastet e permbytjeve ne kohen e perfundimit si dhe gjate punimeve permanente dhe te perkohshme . Kontraktorit nuk i takon asnje pagese shtese si pasoje e ndodhjes .

1.1- Projekti i asfaltimit te rruges

Projekt Zbatimi Ndertim Rruga THEMISTOKLI GERMENJI" RRUGA "SHTESA VANGJEL KOCA", BABRRU SHPAT,FUSHË - KËRÇIK.

- Gjatesia e Rruges Themistokli Germenji $l=340$ m , $B= 6$ m ,
 $b= 4.5$ m, kunete $1*0.5$, trotuar $1*1$
- Gjatesia e Rruges Shtesa Vangjel Koca $L=78$ m, $B= 4$ m, $b= 4$ m

Ne zgjidhjen e projektit jane pasur parasysh:

- a) Zgjidhja ne anen Planimetrike te Rruges .
- b) Zgjidhja ne anen altimetrike te Rruges .
- c) Elementet sociale te rruges.



1. Zgjidhja Planimetrike

Ne zgjidhjen planimetrike eshte pasur parasysh asfaltimi i rruges te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese dhe te lihen hapesirat e nevojshme per zhvillimin ne te ardhmen te infrastruktures nentokesore.

Ne kryqezime eshte bere rakordimi i kthesave me rreze te tille qe lejon kthimin normal te mjeteve.

2. Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik ne drejtimin gjatesor ka nje pjerresi te relativisht te madhe nga jugu ne veri dhe nga lindja ne perendim. Meqe objekti i ri do te ndertohet mbi nje rruge ekzistuese e cila ka nivelete te çrregullt, do te synohet ne krijimin e nje nivelete me pjerresi te lehte e uniforme.

3. Profili Gjatesor.

Profili gjatesor perfaqeson prerjen e rruges sipas aksit te saj ne drejtimin vertikal. Profili gjatesor eshte hartuar ne shkalle vertikale 1:100 dhe ne shkalle horizontale 1:1000.

Ne te jane paraqitur:

- Vija e Terrenit
- Vija e Projektit
- Disnivelet e Vijes se Projektit
- Numri i Piketes (Seksionit)
- Kuota e Terrenit
- Kuota e Projektit
- Distanca Pjesore
- Distanca Progressive

4. Profilat Terthore.

Profilat terthore perfaqesojne prerje te rruges terthor me aksin e saj ne drejtimin vertikal.

Profilat terthore jane hartuar ne shkalle vertikale dhe horizontale 1:100.

Ne profilat terthore jane paraqitur:

- Numri i profilit
- Distanca progresive
- Vija e terrenit
- Vija e projektit
- Disnivelet e vijes se projektit
- Numri i piketes
- Kuotat e terrenit
- Kuotat e projektit
- Distanca pjesore nga aksi
- Distanca e pergjithshme nga aksi

5. Profilat Terthore.

Ne profilat tip jane paraqitur ne menyre te detajuar ne shkalle 1:50

- Shtresat rrugore
- Dimensionet e tyre
- Vendosja e tyre
- Distancat
- Zona ku aplikohet profili tip

6. Zgjidhja sociale.

Duke pasur parasysh qe kjo zone eshte ne zhvillim e siper eshte pasur parasysh qe kjo rruge te behet me parametra qe t'i pershtaten zhvillimit te zones dhe hyrje daljet nga shtepite te kene lirshmeri.

7. Llogaritja e shtresave te rruges.

Nga studimi i gjendjes ekzistuese del qe asfaltimi do te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese me pjerresi ne njerin krahe.



4. PERMBAJTJA E PROJEKT - ZBATIMIT

PROJEKT - ZBATIMI PERMBAN KETO KAPITUJ

KAPAKU I PROJEKTIT

FOTO TE OBJEKTIT

PLANIMETRIA EKZISTUESE

PLANIMTRIA E TROTUAREVE

PROFILAT TERTHORE TIP

PROFILAT TERTHORE

